Latest update: 21/08/20

Charity 1067406

# KORONAVIRUSIN

Reference: www.doctorsoftheworld.org.uk/coronavirus-information/

COVID-19 INFOGRAPHICS

## ÇFARË DUHET TË BËNI NËSE KENI SIMPTOMA?

Vetizolohuni: qëndroni në shtëpi për të paktën **10 DITË** dhe zbatoni udhëzuesin e izolimit

Çdo person tjetër i familjes suaj ose që ka pasur kontakt të afërt me ju duhet të vetizolohet për **10 DITË**

**TESTOHUNI PËR KORONAVIRUSIN BRENDA PESË DITËVE TË PARA NGA SHFAQJA E SIMPTOMAVE**

Nëse banoni me një person që është **70 vjeç e lart**, ka **një problem shëndetësor afatgjatë**, është **shtatzënë**, ose ka sistem **imunitar të dobësuar**, mundohuni të gjeni një vend tjetër qëndrimi për të për **10 DITË**

## PËR TË REZERVUAR NJË TEST

**Vizitoni adresën**
www.nhs.uk/ask-for-a-coronavirus-test

Nëse nuk keni akses në internet **TELEFONONI NUMRIN 119**
ose numrin **0800 028 2816** në Skoci

Ju duhet të jepni të dhënat tuaja të kontaktit dhe të keni një celular në gjendje pune për të marrë rezultatet e testit me sms

## UDHËZUESI I IZOLIMIT

Mos shkoni në punë, shkollë, klinika të mjekëve të përgjithshëm, farmaci ose spitale

Shmangni kontaktin e afërt me persona të tjerë

Zbatoni udhëzuesin për vizitorët

Lani rregullisht duart

Kërkoni që t'jua sjellin ushqimin dhe barnat

Merrni paracetamol për të lehtësuar simptomat

Pini shumë ujë

Nëse është e mundur, flini vetëm

Përdorni pajisje të veçanta, ose pastrojini ato ndërmjet përdorimeve

## KUR DUHET TË KONTAKTONI ME NHS 111?

**KY ËSHTË NJË NUMËR PA PAGESË**

**Ndiheni aq të sëmurë** saqë nuk mund të kryeni asnjë nga veprimtaritë e zakonshme

**Ndjeni se nuk mund t'i përballoni** simptomat në shtëpi

Gjendja juaj **përkeqësohet**

Mund t'ju caktohet një përkthyes i gjuhës suaj nëse i përgjigjeni në mënyrë të përsëritur me "po" të gjitha pyetjeve.